

KONTRATË SHITJE KUOTE

Në Tiranë, sot më 16/11/2018, lidhet kjo kontrate nga palët si më poshtë:

Shitësi: **Znj. Valentina Gjoka**, shtetase shqiptare, e bija e Frrok, lindur me 01.01.1973 ne Mirdite dhe banuese ne Tirane, mbajtese e kartes se identitetit me nr. 028471638 dhe nr. Personal H351011090, madhore me zotesi juridike per te vepruar
(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "**Shitësi**");

dhe


Blerësi: **Znj. Davë Gjoka**, shtetase shqiptare, lindur me 18.06.1944 ne Simon, Mirdite e banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit me nr. 025078072 dhe nr. Personal E45618012L, madhore me zotesi te plote juridike e per te vepruar;
(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "**Blerësi**");


MEQENESE:

- A. Shitësi zotëron 100% te Kapitalit te Shoqërisë "TOP LINE" Sh.p.k, një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT K21909001C dhe me seli ne Tirane ne rrugen 'Hodo Beg', Njesia nr. 10, Pallati 298, hyrja 16, Tirane; (me poshte referuar "*Shoqeria*");
- B. Shitesi deshiron t'i shese Bleresit dhe Bleresi deshiron te bleje nga Shitesi 100 % Kapitalit te Shoqërisë së lartpërmendur;
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkelidhur te Ortakut te vetem te Shoqerise, Palet deshirojne te lidhin kete Kontrate.

PER SA ME SIPER, palët bien dakord si vijon:

1. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Shitesi i shet Bleresit dhe Bleresi blen nga Shitesi 100 % te kapitalit te Shoqerise «TOP LINE» Sh.P.K., Cmimi i shitjes i rene dakort eshte 100.000 Leke (njqind mije Leke) i cili eshte paguar plotesisht nga bleresi me para ne dore dhe perpara nenshkrimit te kontrates. Palet deklarojne qe nuk kane asnje pretendim lidhur me cmimin e shitjes dhe e konsiderojne ate te shlyer plotesisht.
2. Pronësia mbi kuotat, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësi te Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe qe nga ky moment Bleresit i lind e drejta e regjistrimit te kesaj kontrate ne Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).
3. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se kuota e transferuar ketu, eshte ne pronesine e tij te plote e ligjore dhe e lire nga barra hipoteke apo pengje.
4. Bleresi blen 100% (njqind përqind) te kapitalit te Shoqerise dhe me nënshkrimin e kësaj Kontrate do te zotëroje 100 % te kapitalit te shoqerise "TOP LINE" Sh.p.k. Me nenshkrimin e kesaj kontrate, struktura e ortakeve te shoqerise behet:
 - *Znj. Davë Gjoka behet ortake e vetme dhe zoteruese e 100 % te kapitalit te shoqerise.*


Valentina Gjoka


Dava Gjoka¹

5. Blerësi pranon pronësinë e Kuotes duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotes brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
6. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të Kuotes objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Kontrate u hartua në 3 (tre) origjinale në gjuhën Shqipe. Kontrata bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, date 14.04.2008. Marrëveshja u lexua përpara palëve, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht nga palët.

PALET

SHITESI

Valentina Gjoka



BLERESI

Davë Gjoka

